

Udhëzues përdorimi për Nokia 1110i/1112

9247879

Botimi 2 SQ

DEKLARATA E KONFORMITETIT

Me këtë, KOMPORATA E NOKIAS, deklaron se ky produkt RH-93 është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat tjera të përshtatshme të Direktivës 1999/5/EC.

Një kopje të Deklaratës së Konformitetit mund të gjeni në http://www.nokia.com/phones/declaration_of_conformity/.

CE 0434



Koshi i rrethuar -dhe i kryqëzuar do të thotë që brenda kufinjve të Bashkimit Evropian, në fund të jetës së tij produkti duhet të dërgohet te pika e veçantë e grumbullimit. Kjo zbatohet për pajisjen tuaj, por gjithashtu për çdo paisje ndihmëse që mban këtë simbol. Mos i hidhni këto produkte si mbeturina të përziera në kazanet e bashkisë.

Të drejtat e autorit © 2007 Nokia. Të gjitha të drejtat janë të autorit.

Ndalohet riprodhimi, transferimi, shpërndarja ose ruajtja e një pjese ose e të gjitha përmbajtjeve në këtë dokument në çfarëdo formë, pa lejen paraprake me shkrim të Nokias.

US Patent No 5818437 and other pending patents. T9 text input software Copyright© 1997-2007. Tegic Communications, Inc. All rights reserved.

Nokia, Nokia Connecting People, X dhe Y janë markat ose markat e regjistruara të korporatës së Nokias. Emrat e tjerë të produkteve dhe të shoqërive të përmendura këtu, mund të jenë marka të pronarëve të tyre përkatës.

Melodia e Nokias është tingull zanor i shoqërisë tregtare Nokia.

Nokia përdor një politikë të zhvillimit të vazhdueshëm. Nokia ka të drejtën t'i bëjë ndryshime dhe përmirësime çdo produkti nga ata të përshkruar në këtë dokument, pa njoftim paraprak.

Nokia nuk do të jetë përgjegjëse në asnjë rast për çdolloj humbjeje të të dhënave ose të të ardhurave ose të çdolloj dëmtimi të tërthortë, të veçantë, të rastësishëm ose shkakësor, sido që të jetë shkaktuar.

Përmbajta e këtij dokumenti jepet "pa ndryshime". Me përjashtim të rasteve kur kërkohet nga ligji në fuqi, nuk jepet asnjë lloj garancie, e shprehur apo e nënkuptuar, duke përfshirë, por pa kufizuar, garancitë e nënkuptuara të tregtueshmërisë dhe të volisë për një qëllim të caktuar, në lidhje me saktësinë, rregullshmërinë ose përmbajtjet e këtij dokumenti. Nokia rezervon të drejtën ta rishikojë këtë dokument ose ta tërheqë atë në çdo kohë, pa njoftim paraprak.

Disponueshmëria e produkteve të veçanta mund të ndryshojë sipas rajoneve. Jeni të lutur të kontaktoni shitësin më të afërt të Nokia-s.

Kjo pajisje mund të përmbajë produkte, teknologji, ose programe kompjuterike që u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të eksportit nga Sh.B.A. dhe vendet e tjera. Ndryshime në kundërshtim me ligjin janë të ndaluara.

9247879 / botimi 2 SQ

Përmbajtja

Për sigurinë tuaj.....	7
Informacion i përgjithshëm.....	13
Kodet e përdorimit.....	13
Kujtesa e përbashkët.....	14
1. Fillimi.....	15
Çelësat dhe pjesët.....	15
Vendosja e kartës SIM dhe baterisë.....	16
Ngarkoheni baterinë.....	17
Ndezja dhe fikja.....	18
Modaliteti i demonstrimit.....	19
Kalimi shkurt në gjendjen e pritjes.....	20
Kyçja e tastierës.....	21
2. Funksonet e telefonatës.....	22
Për të bërë dhe për t'iu përgjigjur një telefonate.....	22
Altoperlanti.....	23
3. Shkrimi i tekstit.....	24
4. Funksonet e menysë.....	26
Mesazhet.....	26
Kontaktet.....	30
Regjist. thirrje.....	32

P ë r m b a j t j a

Cilësimet.....	33
Ora.....	39
Kujtesat.....	39
Shtesat	40
Shërbimet SIM	42
5. Informacioni për baterinë.....	43
Ngarkimi dhe shkarkimi	43
Orientimet e origjinalitetit të baterive Nokia	45
6. Pajisjet ndihmëse.....	50
Kujdesi dhe mirëmbajtja	51
Informacion shtesë mbi sigurinë	54

Për sigurinë tuaj

Lexoni këto orientime të thjeshta. Mosndjekja e tyre mund të jetë e rrezikshme ose ilegale. Për informacion të mëtejshëm lexoni me hollësi udhëzuesin e përdoruesit.



HAPENI ME KUJDES

Mos e hapni telefonin kur përdorimi i telefonit celular është i ndaluar ose kur ai mund të shkaktojë ndërhyrje ose rrezik.



SIGURIA NË RRUGË ËSHTË PARËSORE

Zbatoni të gjitha ligjet lokale. Kur jeni duke ngarë automjetin, mbajini duart gjithmonë të lira për ta komanduar atë. Gjatë ngarjes së automjetit rëndësi parësore duhet të ketë siguria në rrugë.



NDËRHYRJA

Të gjithë telefonat celularë mund të jenë të ndjeshëm ndaj ndërhyrjes e cila mund të ndikojë në funksionimin e tyre.

Për sigurinë tuaj



MBYLLENI NË SPITALE

Ndiqui të gjitha masat kufizuese. Mbylleni telefonin kur jeni pranë aparaturave mjekësore.



MBYLLENI NË AEROPLAN

Ndiqui të gjitha masat kufizuese. Pajisjet celulare mund të shkaktojnë ndërhyrje në aeroplan.



MBYLLENI KUR JENI DUKE MBUSHUR AUTOMJETIN ME KARBURANT

Mos e përdorni telefonin në një pikë karburanti.
Mos e përdorni afër zjarrit ose lëndëve kimike.



MBYLLENI AFËR SHPËRTHIMEVE

Ndiqui të gjitha masat kufizuese. Mos e përdorni telefonin gjatë një shpërthimi.



PËRDORENI ME ARSYE

Përdoreni vetëm në pozicion normal ashtu si shpjegohet në dokumentacionin e produktit.
Mos e prekni pa arsye antenën.



SHËRBIMI I KUALIFIKUAR

Këtë produkt mund ta instalojë ose riparojë vetëm një personel i kualifikuar.



PAJISJET NDIHMËSE DHE BATERITË

Përdorni vetëm pajisje ndihmëse dhe bateri të aprovuara. Mos lidhni produkte që nuk përputhen.



REZISTENCA-NDAJ UJIT

Telefoni juaj nuk i reziston-ujit. Mbajeni të thatë.



KOPJET-REZERVË

Kini parasysh që të bëni kopje-rezervë ose të mbani një shënim me shkrim për të gjithë informacionin e rëndësishëm të ruajtur në telefonin tuaj.



LIDHJA ME PAJISJE TË TJERA

Kur ta lidhni me ndonjë pajisje tjetër, lexoni udhëzuesin e përdoruesit të asaj pajisjeje për udhëzime të detajuara në lidhje me sigurinë. Mos lidhni produkte që nuk përputhen.

Për sigurinë tuaj



THIRRRJET E URGJENCËS

Sigurohuni që telefoni është i hapur dhe në shërbim. Shtypni butonin e mbylljes aq herë sa të jetë e nevojshme për të pastruar ekranin dhe për t'u kthyer në ekranin fillestar. Fusni numrin e urgjencës dhe më pas shtypni butonin e telefonatës. Jepni vendndodhjen tuaj. Mos e përfundoni thirrjen derisa t'ju japin lejen për ta përfunduar.

■ Rreth pajisjes tuaj

Pajisja celulare e përshkruar në këtë udhëzues është aprovuar për përdorim në rrjetet EGSM 900 dhe GSM 1800. Për më tepër informacion rreth rrjeteve, kontaktoni me furnizuesin tuaj të shërbimit.

Kur të përdorni mundësitë e kësaj pajisjeje, zbatoni të gjitha ligjet dhe respektoni të drejtat private dhe legjitime të të tjerëve.



Paralajmërim: Për të përdorur çfarëdolloj mundësie të kësaj pajisjeje, përveç orës me zile, pajisja duhet të jetë e hapur. Mos e hapni pajisjen kur përdorimi i pajisjeve celulare mund të shkaktojë interferencë ose rrezik.

■ Shërbimet e rrjetit

Për të përdorur telefonin ju duhet të keni shërbim nga një furnizues i shërbimit celular. Funksionimi i shumë prej mundësive të kësaj pajisjeje, varet nga mundësitë e rrjetit celular. Këto shërbime të rrjetit mund të mos disponohen në të gjitha rrjetet ose juve do t'ju duhet të bëni marrëveshje specifike me furnizuesin tuaj të shërbimit përpara se të shfrytëzoni shërbimet e rrjetit. Furnizuesit tuaj të shërbimit mund t'i duhet t'ju japë udhëzime shtesë për përdorimin e tyre dhe t'ju shpjegojë çmimet që do të përdorë. Disa rrjete mund të kenë kufizime gjë e cila ndikon në mënyrën sesi mund të përdorni shërbimet e rrjetit. Për shembull, disa rrjete mund të mos mbështesin të gjitha shërbimet dhe shkronjat që varen nga gjuhët.

Furnizuesi juaj i shërbimit mund të ketë bërë kërkesë që në pajisjen tuaj të nxjerrë jashtë përdorimit ose të mos

Për sigurinë tuaj

aktivizojë disa mundësi të caktuara. Në këtë rast, ato nuk do të shfaqen në menynë e pajisjes suaj. Pajisja juaj mund të ketë qenë e konfiguruar posaçërisht. Ky konfigurim mund të përfshijë ndryshime në emrat e menysë, në renditjen e menysë dhe të ikonave. Për informacion të mëtejshëm, kontaktoni me furnizuesin tuaj të shërbimit.

Ngarkuesit dhe pajisjet ndihmëse

Gjithmonë mbylleni pajisjen dhe shkëputeni ngarkuesin përpara se të hiqni baterinë.

Kontrolloni numrin e modelit të cilido mbushësi para se ta përdorni me këtë pajisje. Kjo pajisje është bërë për përdorim kur të furnizohet me rrymë nga një mbushës AC-2, ACP-7 ose ACP-12.



Paralajmërim: Përdorni me këtë model të veçantë vetëm bateri, ngarkues dhe pajisje ndihmëse të aprovuara nga Nokia. Përdorimi i çdo lloji tjetër mund të zhvlerësojë çdo aprovim ose garanci dhe mund të jetë i rrezikshëm.

Për disponueshmërinë e pajisjeve ndihmëse të aprovuara, luteni të kontaktoni me shitësin tuaj.

Informacion i përgjithshëm

■ Kodet e përdorimit

- Kodi i sigurimit, i furnizuar me telefonin, ndihmon mbrojtjen e telefonit tuaj nga përdorimi i paautorizuar. Kodi i paracaktuar është 12345.
- Kodi PIN, i furnizuar me kartën SIM, ndihmon mbrojtjen e kartës nga përdorimi i paautorizuar.
- Kodi PIN2, i furnizuar me disa karta SIM, është i nevojshëm për të përdorur disa shërbime.
- Kodet PUK dhe PUK2 mund të furnizohen me kartën SIM. Në qoftë se fusni gabimisht tre herë rresht kodin PIN ose PIN2, do t'ju kërkohet kodi PUK ose PUK2. Në qoftë se nuk i keni ato, kontaktoni ofruesin tuaj lokal të shërbimit.

Për të vendosur si telefoni juaj përdor kodet e përdorimit dhe cilësimet e sigurimit, zgjidhni [Menyja](#) > [Cilësimet](#) > [Cilësimet e sigurimit](#).

■ Kujtesa e përbashkët


Mundësitë e mëposhtme të kësaj pajisjeje mund të kenë kujtesë të përbashkët: *Mesazhet*, *Kontaktet* dhe *Kompozimi*. Përdorimi i njërës ose i disave prej këtyre mundësive mund të reduktojë kujtesën që disponohet për kujtesën e përbashkët të mundësive që mbeten. Për shembull, ruajtja e shumë mesazheve me tekst mund të përdorë të gjithë kujtesën e disponueshme. Pajisja juaj mund të shfaqë një mesazh që kujtesa është plot, kur ju përpiqeni të përdorni një mundësi të kujtesës së përbashkët. Në këtë rast, përpara se të vazhdoni, fshini disa nga informacionet ose shënimet e ruajtura në mundësitë e kujtesës së përbashkët. Disa prej mundësive, të tilla si *Kontaktet* mund të kenë një sasi kujtese të përcaktuar posaçërisht për to, përveç kujtesës së përbashkët me tiparet e tjera.

1. Fillimi

■ Çelësat dhe pjesët

Kur telefoni është i gatshëm për përdorim dhe asnjë shkronjë nuk është futur, telefoni është në gjendjen e pritjes.

- Intensiteti i rrjetit (1)
- Niveli i ngarkimit të baterisë (2)
- Funksonet e butonit të zgjedhjes (3)
- Butonat e zgjedhjes (4)
- Butonat e lëvizjes (5)
- Butoni i telefonatës (6)
- Butoni i mbylljes dhe butoni i ndezjes (7)
- Tastiera (8)



■ Vendosja e kartës SIM dhe baterisë

Mbajini të gjitha kartat SIM në vende ku nuk mund t'i prekin fëmijët e vegjël.

Për disponueshmërinë dhe informacion rreth përdorimit të shërbimeve të kartës SIM, kontaktoni me shitësin e kartës suaj SIM. Ai mund të jetë furnizuesi i shërbimit, operatori i rrjetit, ose ndonjë shitës tjetër.

Ky telefon duhet të përdoret me bateri BL-5CA.

1. Shtypni butonin e hapjes së kapakut të pasëm (1), hapni kapakun e pasëm dhe hiqeni atë (2, 3). Ngrini baterinë nga mjeti kapës dhe hiqeni atë (4).



2. Ngrini me kujdes mbajtësin e kartës SIM nga mjeti kapës i telefonit (5). Fusni kartën SIM duke u siguruar që skaji i pjerrtë të jetë në anën e djathtë të sipërme kurse

kontakti i artë të jetë i kthyer me drejtim poshtë (6). Mbylleni mbajtësin e kartës SIM (7), dhe shtypeni atë për t'a kyçur në vendin e tij. Futni baterinë (8, 9).



■ Ngarkojeni baterinë

1. Lidhni ngarkuesin me një prizë të korrentit alternativ në mur.
2. Lidhni ngarkuesin me një telefon. Shenja e baterisë fillon të lëvizë.



Nëse **Nuk ngarkon** shfaqet, prisni për njëfarë kohe, shkëputeni ngarkuesin, lidhni përsëri dhe provojeni prapë. Nëse përsëri karikimi nuk fillon, kontaktoni shitësin tuaj.

Fillimi


3. Kur bateria është plotësisht e mbushur, shiriti ndërpreen së mbushuri. Shkëputeni mbushësin nga telefoni dhe nga priza e murit.

■ Ndezja dhe fikja

Shtypeni dhe mbajeni të shtypur butonin e mbylljes për disa sekonda.

Përdoreni telefonin vetëm në pozicionin e tij normal të funksionimit.

Pajisja juaj ka një antenë të brendshme.





Shënim: Ashtu si dhe me çdo pajisje tjetër radiotransmetuese, mos e prekni antenën pa qenë nevoja, kur pajisja është e hapur. Kontakti me antenën ndikon në cilësinë e thirrjes dhe mund të bëjë që pajisja të funksionojë me një fuqi me nivel më të lartë sesa ai i nevojshëm. Gjatë përdorimit të pajisjes, shmangia e kontaktit me hapësirën e antenës bën që funksionimi i antenës si dhe jetëgjatësia e baterisë të jenë optimale.



Shënim: Shmangni prekjen e këtij lidhësi pasi ai është mjaft i ndjeshëm ndaj shkarkimeve elektrostatike.



■ Modaliteti i demonstrimit

Mund të shihni sesi të përdorni disa mundësi të telefonit tuaj. Në qoftë se karta SIM nuk është instaluar, zgjidhni

Demo > *Themelorë*, *Më tepër* ose *Lojrat*.

Fillimi

Në qoftë se karta SIM është instaluar, zgjidhni **Menyja** > *Shtesat* >, *Demonstrimi* > ose *Më tepër*.

■ Kalimi shkurt në gjendjen e pritjes

Lëvizja për përdorimin e *Regjist. thirrje..*

Lëvizja poshtë për të shkuar tek emrat dhe numrat e ruajtur në *Kontaktet*.

Lëvizja majtas për të shkruar një mesazh.

Lëvizja djathtas për të parë modalitetin e demonstrimit.

Shtypni dhe mbajeni të shtypur * për të aktivizuar orën folëse.

Shtypni butonin e telefonatës njëherë për të hyrë në listën e numrave që keni telefonuar. Lëvizni tek emri që dëshironi dhe për t'i telefonuar këtij numri shtypni butonin e telefonatës.

■ Kycja e tastierës

Për të bllokuar tastierën për të penguar shtypjen e rastësishme të butonave, zgjidhni **Menyja**, dhe shtypni * shpejt; për të zhblokuar, zgjidhni **Shkyç**, dhe shtypni * shpejt.



Kur bllokimi i tastierës është aktiv, mund të jetë akoma e mundur thirrja e numrave zyrtarë të urgjencës që janë programuar në pajisjen tuaj.

Vendosni numrin e emergjencës dhe shtypni butonin e telefonatës. Numri i emergjencës që keni vendosur mund të mos shfaqet në ekran.

2. Funksionet e telefonatës

■ Për të bërë dhe për t'iu përgjigjur një telefonate

Për të bërë një telefonatë, veproni si më poshtë:

1. Fusni numrin e telefonit duke përfshirë edhe kodin e zonës nëse është e nevojshme. Kodi i shtetit duhet të përfshihet nëse është e nevojshme.
2. Shtypni butonin e telefonatës për t'i telefonuar këtij numri. Lëvizni në të djathtë për të rritur ose në të majtë për të zvogëluar volumin e kufjes gjatë telefonatës.

Për t'iu përgjigjur një telefonate, shtypni butonin e telefonatës. Për të refuzuar telefonatën pa u përgjigjur, shtypni butonin e mbylljes.

■ Altoparlanti

Nëse është i disponueshëm, mund të zgjidhni **Altopar.** ose **Telefo.** të përdorni altoparlantin ose kufjen e telefonit gjatë një telefonate.



Paralajmërim: Mos e mbani pajisjen afër veshit kur jeni duke përdorur altoparlantin sepse zëri mund të jetë tepër i lartë.

3. Shkrimi i tekstit

Ju mund të fusni tekst në dy mënyra të ndryshme: futja tradicionale e tekstit e shënuar me  ose futja e tekstit të parashikuar (fjalor i inkorporuar) i shënuar me .

Për të përdorur futjen tradicionale të tekstit, shtypni butonin që ka shenjën e shkronjës që dëshironi derisa të shfaqet kjo shkronjë.

Për të ndezur futjen e tekstit të parashikuar kur shkruani tekst, zgjidhni **Mundës.** > *Fjalorë* he gjuhën e dëshiruar; për ta mbylluar atë, zgjidhni **Mundës.** > *Pa fjalor.*

Për të përdorur futjen e tekstit të parashikuar, veproni si më poshtë:

1. Për të futur fjalën që dëshironi, shtypni çdo buton njëherë për një shkronjë të vetme.
2. Nëse fjala e shfaqur është ajo fjalë që ju dëshironi, shtypni **O** dhe filloni të shkruani fjalën tjetër.

Shkrimi i tekstit

Për të ndryshuar fjalën, shtypni * vazhdimisht derisa të shfaqet fjala që ju dëshironi.

Në qoftë se ? shfaqet pas fjalës, fjala nuk është në fjalor. Për të shtuar një fjalë në fjalor, zgjidhni **Fjalori**, fusni fjalën (duke përdorur futjen tradicionale të tekstit) dhe zgjidhni **OK**.

Këshilla për të shkruar tekstin me futjen tradicionale dhe të parashikuar të tekstit:

- Për të shtuar një hapësirë, shtypni **0**.
- Për të ndryshuar shpejt mënyrën e futjes së tekstit kur shkruani tekst, shtypni **#** vazhdimisht dhe kontrolloni treguesin në pjesën e sipërme të ekranit.
- Për të shtuar një numër, shtypni dhe mbani të shtypur butonin e numrit të dëshiruar.
- Për të marrë një listë të shkronjave të veçanta kur përdoret futja tradicionale e tekstit, shtypni *****; kur përdoret futja e tekstit të parashikuar, shtypni dhe mbani të shtypur *****.

4. Funksionet e menysë

Në gjendjen e pritjes, zgjidhni [Menyja](#) dhe menynë dhe nën-menynë e dëshiruar. Për t'u larguar nga niveli i tanishëm i menysë, zgjidhni [Dil](#) ose [Mbrapa](#). Shtypni butonin e mbylljes për t'u kthyer drejtpërdrejt në gjendjen e pritjes.

Jo të gjitha funksionet e menysë apo elementët e zgjedhjeve janë të përshkruara këtu.

Mesazhet



Cilësimet e mesazheve

Për të ndryshuar cilësimet e mesazhit, zgjidhni [Menyja](#) > [Mesazhet](#) > [Cilësimet e mesazheve](#).

Për të ruajtur numrin e telefonit të nevojshëm për dërgimin e mesazheve me tekst dhe me fotografi, zgjidhni [Profili i dërgimit](#) > [Numri i qendrës së mesazheve](#). Këtë numër e merrni prej ofruesit tuaj të shërbimit.

Për të vendosur nëse është përdorur kodimi i plotë apo i reduktuar gjatë dërgimit të mesazheve në tekst, zgjidhni *Mbështetja e shenjave* (shërbimi i rrjetit) > *E plotë* ose *I reduktuar*.

Për të parë apo ndryshuar listën e numrave të filtruar, zgjidhni *Nr. e padëshiruar*.

Shkrim i mesazhit

Pajisja juaj mbështet dërgimin e mesazheve me tekst, pa kufizuar numrin e shkronjave për një mesazh të vetëm. Mesazhet që e kalojnë kufirin do të dërgohen si një seri e përbërë prej dy ose më shumë mesazhesh. Tarifa e furnizuesit tuaj të shërbimit mund të jetë në përputhje me numrin e mesazheve. Shkronjat që përdorin thekse ose shenja të tjera si dhe shkronjat që vijnë nga gjuhë si ajo kineze, kërkojnë më shumë hapësirë duke kufizuar kështu numrin e shkronjave që mund të dërgohen në një mesazh të vetëm.

Numri i shkronjave që disponohen dhe numri aktual i pjesës së një mesazhi me shumë pjesë tregohet në pjesën e sipërme të djathtë të ekranit, për shembull, 917/1.

Funksionet e menysë

1. Zgjidhni **Menyja** > *Mesazhet* > *Shkrim i mesazhit*.
2. Shkruani mesazhin.
3. Për të dërguar mesazhin, zgjidhni **Mundës.** > *Dërgo*, fusni numrin e telefonit të personit marrës, dhe zgjidhni **OK**.



Shënim: Kur dërgoni mesazhe, pajisja juaj mund të shfaqë *Mesazhi u dërgua*. Ky është një tregues që mesazhi është dërguar nga pajisja juaj te numri i qendrës së mesazheve që është programuar në pajisjen tuaj. Ky nuk është një tregues që mesazhi është marrë nga destinacioni i synuar. Për detaje të mëtejshme për shërbimet e mesazhimit, pyesni furnizuesin tuaj të shërbimit.

Leximi i mesazhit tekst

Kur merrni një mesazh tekst, numri i mesazheve të reja si dhe një ikonë  shfaqen në ekran në gjendjen e pritjes.

Zgjidhni **Shfaq** për të parë mesazhet menjëherë, ose **Dil** për ti parë mesazhet më vonë **Menyja** > *Mesazhet* > *Të ardhura*.

Skicat dhe Të dërguara

Në menynë [Skicat](#), mund të shihni mesazhet që keni ruajtur me menynë [Ruaj mesazhin](#). Në menynë [Të dërguara](#), mund të shihni kopje të mesazheve që keni dërguar.

Mesazhet me figura

Mund të merrni dhe të dërgoni mesazhe që përmbajnë fotografi (shërbim i rrjetit). Mesazhet me fotografi të marra ruhen në [Të ardhura](#). Vini re se çdo mesazh me fotografi përbën disa mesazhe me tekst. Kështu që dërgimi i një mesazhi me fotografi mund të kushtojë më shumë sesa një mesazh me tekst.



Shënim: Funksioni i mesazheve me figurë mund të përdoret vetëm nëse mbështetet nga operatori juaj i rrjetit ose nga furnizuesi juaj i shërbimit. Vetëm pajisjet që përputhen të cilat ofrojnë mundësi të mesazheve me figurë mund të marrin dhe të shfaqin mesazhe me figurë. Shfaqja e një mesazhi mund të ndryshojë në varësi të pajisjes marrëse.

Fshirje e mesazheve

Për të fshirë të gjithë mesazhet e lexuar ose të gjitha mesazhet në një dosje, zgjidhni **Menyja** > **Mesazhet** > **Fshirje e mesazheve** > **Të gjitha të lex.** ose dosjen e dëshiruar.

Kontaktet

Mund të ruani emrat dhe numrat e telefonit në kujtesën e telefonit dhe në kujtesën e kartës SIM. Numratori telefonik i brendshëm mund të mbajë deri në 200 emra.



Kërkoni për një emër dhe numër telefoni

Lëvizni poshtë në gjendjen e pritjes dhe vendosni shkronjat e para të emrit. Lëvizni për tek emri që dëshironi.

Ju gjithashtu mund të përdorni alternativat e mëposhtme në menynë **Kontaktet**:

Shto kontaktin—për të ruajtur emra dhe numrat e telefonit në numratorin telefonik

Fshij—për të fshirë emra dhe numrat e telefonit nga numeratori telefonik veçan apo të gjithë përnjëherësh

Kopjo—për të kopjuar emra dhe numrat e telefonit të gjithë përnjëherësh ose një nga një nga numeratori telefonik i brendshëm në numeratorin telefonik të kartës SIM, ose anasjelltas

Cilësimet për kontaktet

Zgjidhni **Menyja** > *Kontaktet* > *Cilësimet* dhe nga alternativat e disponueshme:

Kujtesa në përdorim—Për të zgjedhur nëse emrat dhe numrat e telefonit janë ruajtur në *E telefonit* ose *E kartës SIM*. Kur ndryshoni kartën SIM, *E kartës SIM* kujtesa zgjidhet automatikisht.

Shfaqja e kontakteve—Për të zgjedhur si shfaqen emrat dhe numrat e telefonit. Kur shihni **Detajet** e një kontakti me *Shfaqja e kontakteve* duke filluar me *Lista e emrave* ose *Vetëm emrin*, emri apo numri i telefonit i ruajtur në kujtesën e kartës SIM tregohet nga  dhe emri apo numri i telefonit i ruajtur në kujtesën e telefonit është tregohet nga .

Funksionet e menysë

Gjendja e kujtesës—Për të kontrolluar sa emra dhe numra të telefonit tashmë janë ruajtur dhe sa akoma mund të ruhen në secilin numerator telefonik

■ Regjist. thirrje.



Telefoni regjistron numrat e telefonit të thirrjeve të humbura, thirrjeve të marra dhe thirrjeve të bëra; kohëzgjatjen e përafërt të thirrjeve; dhe numrin e mesazheve të dërguara dhe të marra.

Telefoni regjistron telefonatat e humbura dhe të marra nëse është i ndezur, brenda zonës së rrjetit të shërbimit dhe nëse rrjeti i mbështet këto funksione.

Matësit e telefonatës

për të parë kohëzgjatjen mesatare të telefonatës së fundit, të gjithë telefonatat e marra, të gjitha telefonatat e dërguara, ose kohëzgjatjen mesatare të të gjitha telefonatave, zgjidhni **Menyja** > *Regjist. thirrje.* > *Zgjatja e thirrjeve.*

Funksionet e menysë

Për të rivendosur matësit, zgjidhni *Fshirja e matësve*, vendosni kodin e sigurisë dhe zgjidhni **OK**.



Shënim: Fatura aktuale për thirrjet dhe shërbimet nga furnizuesi juaj i shërbimit mund të ndryshojë në varësi të mundësive të rrjetit, rumbullakosjeve të faturimit, taksave e kështu me radhë.

■ Cilësimet

Në këtë meny, gjithashtu mund të ndryshoni cilësimet e ndryshme të telefonit. Për të rivendosur disa nga cilësimet e menysë në vlerat e tyre të paracaktuara, zgjidhni *Rivend. cilës. të fabrikës*



Cilësimet e tingujve

Zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilësimet e tingujve* dhe nga alternativat e disponueshme:

Tingulli i thirrjes—për të vendosur tonet e telefonatave

Lartësia e tingullit të thirrjes—për të vendosur nivelin e volumit të tingullit të ziles dhe tingullit të lajmërimit të

Funksionet e menysë

mesazhit. Nëse keni vendosur *Lartësia e tingullit të thirrjes* nivelin 2 ose më sipër, telefoni juaj do të tingëllojë me volumin e ziles në zbritje nga niveli 1 në nivelin që e keni përcaktuar kur keni një telefonatë.

Lajmërimi me dridhje—për të vendosur telefonin të vibrojë kur ju pranoni një thirrje apo një mesazh me tekst

Ting. lajmërim. të mesazhit—për të vendosur tonin të tingëllojë kur pranoni një mesazh me tekst

Tingujt paralajmërues—për të vendosur telefonin në tonet tingëlluese, për shembull, kur bateria zbrazet nga fuqia

Cilësimet e shfaqjes

Zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilësimet e shfaqjes*.

Për të vendosur që telefoni të shfaq orën digjitale apo klasike dhe të gjitha ikonat kryesore të ekranit si ekran-ruajtës, zgjidhni *Ora e ruajtësit të fuqisë*.

Profilet

Mund të bëni ndryshime në profilet për të përdorur disa mundësi, p.sh. tonet e ziles dhe ekran-ruajtësin.

Zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Profilet*, profilin që dëshironi ta ndryshoni, dhe *Përshtat*.

Cilësimet e orës

Për të fshehur apo shfaqur orën, për të vendosur kohën apo për të ndryshuar formën e kohës, zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilësimet e orës* > *Ora*.

Në qoftë se bateria është hequr nga telefoni, do t'ju duhet që sërish të vendosni orën dhe datën.

Cilësimet e thirrjeve

Zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilësimet e thirrjeve*.

Për të kaluar thirrjet e pranuar në postën tuaj me zë apo në ndonjë numër telefoni tjetër, zgjidhni *Devijimi i thirrjeve* (shërbimi i rrjetit) dhe alternativën e dëshiruar të kalimit. Zgjidhni *Aktivizo* për të vendosur alternativën e zgjedhur të kalimit dhe *Anulo* për ta mbyllur atë; për të kontrolluar nëse alternativa e zgjedhur është aktive, zgjidhni *Kontrollo gjend.*; për të cilësuar një vonesë për kalime të caktuara, zgjidhni *Cilëso vonesën* (nuk është i disponueshëm për të

Funksionet e menysë

gjitha alternativat e kalimit). Disa alternativa devijimi mund të jenë aktive në të njëjtën kohë. Kur *Devijo të gjitha thirrjet zanore* është aktivizuar,  tregohet në ekran në gjendjen e pritjes. Për të ç'aktivizuar të gjitha devijimet e thirrjeve, zgjidhni *Anulimi i të gjitha devijimeve*.

Për të përcaktuar nëse numri juaj i telefonit shfaqet apo fshihet tek personi që ju kërkoni, zgjidhni *Dërgo të dhënat e mia* (shërbimi i rrjetit).

Për të vendosur telefonin tuaj për të bërë deri 10 përpjekje për të lidhur thirrjen pas një përpjekje të pasuksesshme të telefonatës, zgjidhni *Përsëritja automatike*.

Për të lejuar që rrjeti t'ju njohtojë kur keni një thirrje përderisa jeni duke zhvilluar një telefonatë, zgjidhni *Shërbimi pritjes së thirrjeve* (shërbimi i rrjetit).

Cilësimi i gjuhës

Për të zgjedhur gjuhën e teksteve në ekran, zgjidhni *Menyja* > *Cilësimet* > *Cilësimet e telefonit* > *Gjuha*.

Cilësimet e shpenzimit



Shënim: Fatura aktuale për thirrjet dhe shërbimet nga furnizuesi juaj i shërbimeve mund të ndryshojë në varësi të mundësive të rrjetit, rrumbullakosjeve të faturimit, taksave e kështu me radhë.

Zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilësimet e shpenzimit* dhe nga cilësimet e mëposhtme:

Kredia e parapaguar (shërbimi i rrjetit) —për të parë informatat lidhur me kredinë e parapaguar

Kronometri i thirrjes—për të ndezur apo fikur shfaqjen e kohës së bisedës

Përmbledhja e thirrjes—për të ndezur apo fikur njoftimin e kohëzgjatjes së përafërt të thirrjeve



Shënim: Kur nuk kanë mbetur më monedha apo impulse, atëherë janë të mundshme vetëm thirrjet e numrave zyrtarë të urgjencës të programuar në pajisje.

Cilësimet pajis. ndihmëse

Zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilësimet pajis. ndihmëse* > *Kufje* ose *Kufje të shurdh.*

Për të vendosur që telefoni automatikisht t'i përgjigjet një thirrjeje pas 5 sekondave, zgjidhni *Përgjigje automatike*.

Menyja e cilësimeve të pajisjeve shtesë do të bëhet e dukshme vetëm pasi një nga pajisjet shtesë është lidhur me telefonin.

Cilësimi i butonit të djathtë për zgjedhje

Në gjendjen e pritjes, mund të zgjidhni **Shko te** të hyni në një listë të kalimeve të shkurta. Për të definuar apo organizuar kalimet e shkurta, zgjidhni **Menyja** > *Cilësimet* > *Cilës. but. zgjedhjes djathtas*. Shkoni tek *Zgjidh mundësi*. për të zgjedhur funksionet që dëshironi si kalime të shkurta; shkoni tek *Organizo* për të organizuar renditjen e funksioneve në listën e kalimeve të shkurta.

■ Ora



Tpër të vendosur kohën e alarmit, zgjidhni **Menyja** > **Ora** > **Ora e alarmit**. Lëvizni kah **Tingulli i ziles** për të zgjedhur tingullin e alarmit, **Përsërit alarm**. për të vendosur që alarmi të tingëllojë vetëm njëherë apo vazhdimisht në ditë të caktuara të javës, dhe **Ora që flet** të lejojë që telefoni ta thotë kohën. Kur tingëllon zilja, zgjidhni **Ndalo** për të fikur zilen ose **Shtyj** për të fikur zilen dhe për ta vendosur atë që të bjerë përsëri pas 10 minutash.

Në qoftë se koha e tingëllimit të ziles arrin kur pajisja është e mbyllur, pajisja hapet vetë dhe fillon tingëllimin e ziles. Në qoftë se zgjidhni **Ndalo**, pajisja ju pyet nëse doni ta aktivizoni pajisjen për thirrjet. Zgjidhni **Jo** për ta mbyllur pajisjen ose **Po** për të bërë dhe për të marrë thirrje. Mos zgjidhni **Po** kur përdorimi i telefonit celular mund të shkaktojë ndërhyrje ose rrezik.

■ Kujtesat



Për të ruajtur një shënim të shkurtë teksti me një alarm, zgjidhni **Menyja** > **Kujtesat** > **Krijo një të**

Funksionet e menysë

re. Kur vjen koha e kujtuesit, zgjidhni **Dil** për të ndaluar zilen ose **Shtyrje** për ta lënë që zilha e telefonit të bjerë përsëri për 10 minuta.

■ Shtesat



Llogaritësi



Shënim: Ky llogaritës ka saktësi të kufizuar dhe është projektuar për llogaritje të thjeshta.

Zgjidhni **Menyja** > **Shtesat** > **Llogaritësi**.

1. Shtypni butonat **0** deri në **9** për të vendosur shifra dhe **#** për të vendosur një pikë dhjetore. Për të ndryshuar shenjëën e numrit të futur, shtypni *****.
2. Lëvizni lartë ose poshtë për të ndriçuar **+**, **-**, **x**, or **/**.
3. Përsërisni hapat 1 dhe 2 nëse është e nevojshme.
4. Për të marrë rezultatet, zgjidhni **Rezult..**

Konvertuesi

Mund të bëni konvertimin e njësive të ndryshme të matjes.

Zgjidhni **Menyja** > *Shtesat* > *Konvertuesi*. Për të përdorur pesë konvertimet tuaja të fundit, zgjidhni *5 konver. fundit*. Ju gjithashtu mund të zgjidhni nga gjashtë kategoritë e njësive të parapërcaktuara.

Mund të shtoni konvertimet tuaja me *Konvert. e mia*.

Kur bëni një konvertim, mund të lëvizni lart ose poshtë për të ndryshuar pozicionet e njësive në konvertim.

Kompozimi

Zgjidhni **Menyja** > *Shtesat* > *Kompozimi* dhe një ton. Për të krijuar tonet tuaja personale, fusni notat. Për shembull, shtypni **4** për notën **f**. Shtypni **8** për të shkurtuar (-) dhe **9** për të zgjatur (+) kohëzgjatjen e notës apo për pushim. Shtypni **0** për të futur një pauzë, * vendosni oktavën dhe **#** bëni notën diez (nuk është e disponueshme për notat **e** dhe **b**).

c	d	e
f	° g °	a
b	▪	+
123	—	#

Pasi të përfundoni cingërimën, zgjidhni **Mundës.** > *Luarj*, *Ruaj*, *Ritmi*, *Dërgo*, *Spastro ekranin* ose *Dil*.

Funksionet e menysë

Lënia e aplikimeve që të funksionojnë në sfond, rrit kërkesën për fuqinë e baterisë dhe redukton jetëgjatësinë e saj.

■ Shërbimet SIM

Karta juaj SIM mund t'ju sigurojë shërbime shitesë që ju mund t'i përdorni. Kjo meny është shfaqur vetëm në qoftë se mbështetet nga karta juaj SIM. Emri dhe përmbajtja e menysë varen nga karta SIM.



Për informacion, kontaktoni furnizuesin tuaj të shërbimit.

5. Informacioni për baterinë

■ Ngarkimi dhe shkarkimi

Pajisja juaj furnizohet me fuqi nga një bateri që mund të ringarkohet. Funksionimi i plotë i një baterie të re arrihet vetëm pas dy ose tre cikleve me ngarkime dhe shkarkime të plota. Bateria mund të ngarkohet dhe shkarkohet shumë herë por pas një farë kohe ajo do të dalë jashtë përdorimit. Kur koha e pritjes dhe bisedat janë më të shkurtra se zakonisht, zëvendësoni baterinë. Përdorni vetëm bateri të aprovuara nga Nokia, dhe ngarkojeni përsëri baterinë vetëm me ngarkues që janë projektuar për këtë pajisje dhe të aprovuar nga Nokia.

Në qoftë se për herë të parë përdoret një bateri zëvendësuese ose në qoftë se bateria nuk është përdorur për një periudhë më të gjatë, mund të jetë e nevojshme të lidhni ngarkuesin dhe pastaj ta shkëpusni dhe rilidhni atë për të filluar ngarkimin.

Informacioni për baterinë

Hiqeni ngarkuesin nga priza elektrike dhe nga pajisja kur nuk është në përdorim. Mos e lini baterinë plotësisht të ngarkuar të lidhur në ngarkues, pasi mbigarkimi mund të shkurtojë jetëgjatësinë e baterisë. Nëse një bateri plotësisht e ngarkuar lihet e papërdorur, ajo do të shkarkohet pas një farë kohe.

Nëse bateria është shkarkuar plotësisht, mund të duhet pak kohë para se të shfaqet në ekran treguesi i ngarkimit ose para se të bëhet ndonjë thirrje.

Përdoreni baterinë vetëm për qëllimin që është krijuar. Mos përdorni asnjëherë ngarkues dhe bateri të dëmtuara.

Mos krijoni qark të shkurtër në bateri. Një qark i shkurtër aksidental mund të ndodhë kur një objekt metalik siç është një monedhë, një kapse, ose stilolaps shkakton një lidhje direkte të dy terminalëve të baterisë domethënë atij pozitiv (+) dhe atij negativ (-). (Ata duken si shirita metalikë mbi bateri.) Kjo gjë mund të ndodhë, për shembull, kur mbani një bateri (si pjesë këmbimi) në xhep apo në çantë. Krijimi i një qarku të shkurtër me terminalët mund ta dëmtojë baterinë ose objektin që shërbeu si lidhës.

Informacioni për baterinë

Lënia e baterisë në vende tepër të nxehta ose të ftohta, si për shembull në një automjet të mbyllur në stinën e verës apo të dimrit, do të reduktojë kapacitetin dhe jetëgjatësinë e baterisë. Përpiquni që ta mbani baterinë gjithmonë midis 15°C dhe 25°C (59°F dhe 77°F). Një pajisje me bateri të nxehtë apo të ftohtë, mund të mos punojë përkohësisht, edhe atëherë kur bateria është plotësisht e ngarkuar. Funksionimi i baterisë është veçanërisht i kufizuar në temperatura që janë shumë gradë nën zero.

Mos i hidhni bateritë në zjarr sepse mund të shpërthejnë. Bateritë mund të shpërthejnë edhe kur janë të dëmtuara. Eliminoni bateritë sipas rregullave lokale. Kur është e mundur lutemi ti riqarkulloni. Mos i eliminoni ashtu si mbeturinat e përditshme.

■ Orientimet e origjinalitetit të baterive Nokia

Për sigurinë tuaj, gjithmonë përdorni bateri origjinale Nokia. Që të siguroheni që jeni duke marrë një bateri origjinale Nokia, blijeni atë nga një shitës i autorizuar nga Nokia, kërkonin që të gjeni mbi ambalazh logon e Nokias për pajisjet

Informacioni për baterinë

ndihmëse origjinale, dhe kontrolloni etiketën e hologramit duke përdorur këto hapa:

Përfundimi me sukses i të katërta hapave nuk ju jep një siguri të plotë për origjinalitetin e baterisë. Në qoftë se keni ndonjë arsye për të besuar se bateria juaj nuk është një bateri e vërtetë origjinale Nokia, atëherë duhet t'i shmangeni përdorimit të saj dhe ta dërgoni te pika më e afërt e shërbimit e autorizuar nga Nokia apo te shitësi për ndihmë. Shitësi ose punonjësit e pikës së shërbimit të autorizuar nga Nokia do ta kontrollojnë baterinë nëse është origjinale apo jo. Nëse origjinaliteti nuk mund të vërtetohet, kthejeni mbrapsht baterinë atje ku e bletë.

Vërtetoni hologramin




1. Kur jeni duke parë hologramin në etiketë, nga njëri cep ju duhet të shikoni simbolin e Nokias që janë dy duar të bashkuara dhe nga cepi tjetër ju duhet të shikoni logon e Nokias për pajisjet ndihmëse origjinale.

Informacioni për baterinë



2. Kur të ktheni cepat e hologramit majtas, djathtas, poshtë dhe lart, ju duhet të shihni 1, 2, 3, dhe 4 pika në çdo anë përkatësisht.



3. Gërvishtni anën e etiketës për të zbuluar një kod me 20 shifra, për shembull 12345678919876543210. Kthejeni baterinë në mënyrë të tillë që numrat të jenë të drejtuar lart. Kodi prej 20 shifrash lexohet duke filluar nga numri që ndodhet në rreshtin e sipërm dhe vazhdon në rreshtin e poshtëm.

Informacioni për baterinë



4. Konfirmoni që kodi prej 20 shifrash është i vlefshëm duke ndjekur udhëzimet që janë në www.nokia.com/batterycheck.

Për të krijuar një mesazh me tekst, fusni kodin 20-shifror, për shembull, 12345678919876543210, dhe dërgoni në +44 7786 200276.

Operatorët përgjegjës kombëtarë dhe ndërkombëtarë do t'i vihen punës.

Ju duhet të merrni një mesazh i cili tregon nëse kodi mund të vërtetohet.

Po në qoftë se bateria juaj nuk është origjinale?

Në qoftë se ju nuk mund ta konfirmoni që bateria juaj Nokia, me hologramin në etiketë nuk është një bateri origjinale Nokia, lutemi të mos e përdorni baterinë. Dërgojeni atë për të kërkuar ndihmë te pika më e afërt e

I n f o r m a c i o n i p ë r b a t e r i n ë

shërbimit e autorizuar nga Nokia ose te një shitës i tillë.

Përdorimi i baterisë që nuk është e aprovuar nga fabrikuesi mund të jetë i rrezikshëm dhe mund të rezultojë në një funksionim të dobët dhe të dëmtojë pajisjen tuaj dhe pajisjet ndihmëse të saj. Ai mund të zhvlerësojë gjithashtu, çdo aprovim apo garanci që zbatohet për pajisjen.

Për të gjetur më shumë informacion rreth baterive origjinale të Nokias, vizitoni www.nokia.com/battery.

6. Pajisjet ndihmëse

Disa rregulla praktike lidhur me aksesorët dhe pajisjet ndihmëse:

- Mbajini të gjithë aksesorët dhe pajisjet ndihmëse në vende ku nuk mund t'i prekin fëmijët e vegjël.
- Kur shkëpusni kordonin e fuqisë së çdo pajisjeje ndihmëse ose aksesori, kapni dhe tërhiqni spinën dhe jo kordonin.
- Kontrolloni rregullisht nëse pajisjet ndihmëse të instaluar në një automjet janë vendosur mirë dhe funksionojnë ashtu si duhet.
- Instalimi i të gjitha pajisjeve ndihmëse të ndërlikuara në automjet, duhet të kryhet vetëm nga një personel i kualifikuar.

Kujdesi dhe mirëmbajtja

Pajisja juaj është një produkt i projektuar me mjeshtëri të lartë dhe duhet të trajtohet me kujdes. Këshillat e mëposhtme do t'ju ndihmojnë të mbronin të drejtën e garancisë.

- Mbajeni të thatë pajisjen. Reshjet, lagështia dhe të gjitha llojet e lëngjeve ose avujve mund të mbajnë minerale që gërryejnë qarqet elektronike. Në qoftë se pajisja juaj laget, hiqeni baterinë dhe mos e vini në vendin e vet derisa pajisja të thahet plotësisht.
- Mos e ruani ose përdorni pajisjen në zona të ndotura dhe me pluhur. Pjesët e saj të lëvizshme dhe komponentët elektronikë mund të dëmtohen.
- Mos e mbani pajisjen në zona të nxehta. Temperaturat e larta mund të shkurtojnë jetëgjatësinë e pajisjeve elektronike, të dëmtojnë bateritë si dhe të shtrembërojnë ose të shkrijnë disa pjesë plastike.

Kujdesi dhe mirëmbajtja

- Mos e mbani pajisjen në zona të ftohta. Kur pajisja kthehet në temperaturën e saj normale, brenda saj mund të krijohet lagështi e cila dëmton panelin e qarqeve elektronike.
- Mos u përpiqni ta hapni pajisjen në një mënyrë të ndryshme nga ajo që udhëzohet në këtë udhëzues.
- Mos e shkundni, hidhni, ose goditni pajisjen. Përdorimi me forcë mund të thyejë panelet e qarqeve të brendshme dhe mekanizmat e imët.
- Mos përdorni për të pastruar pajisjen, lëndë kimike të përqendruara, tretësira pastruese ose detergjentë të fortë.
- Mos e lyeni me bojë pajisjen. Boja mund të bllokojë pjesët e lëvizshme dhe të pengojë funksionimin e duhur.
- Përdorni vetëm antenën që keni blerë ose ndonjë tjetër që është e aprovuar si pjesë këmbimi. Antenat e paautorizuara, modifikimet ose bashkëngjitjet, mund ta dëmtojnë pajisjen dhe mund të shkelin rregullat për rregullimin e radioaparaturave.
- Ngarkuesit përdorini në ambiente të mbyllura.

Kujdesi dhe mirëmbajtja

- Gjithmonë krijoni kopje rezervë të të dhënave që doni të ruani (si p.sh. kontaktet dhe shënimet kalendarike) përpara se ta dërgoni pajisjen tuaj për shërbim teknik.

Të gjitha këshillat e mësipërme vlejnë njëloj si për pajisjen tuaj ashtu dhe për baterinë, ngarkuesin ose çdo pajisje tjetër ndihmëse. Në qoftë se ndonjë pajisje nuk punon si duhet, dërgojeni atë për shërbim te pika më e afërt e autorizuar.

Informacion shtesë mbi sigurinë

Pajisja juaj dhe pajisjet ndihmëse të saj mund të përmbajnë pjesëza të vogla. Mbajini ato në një vend ku nuk mund t'i prekin fëmijët e vegjël.

Ambienti i përdorimit

Kujtohuni që gjithmonë të ndiqni të gjitha rregullat specifike që janë në fuqi në çdo zonë dhe gjithmonë mbylleni pajisjen tuaj kur përdorimi i saj është i ndaluar ose kur mund të shkaktojë ndërhyrje ose rrezik. Përdoreni pajisjen vetëm në pozicionin e saj normal të përdorimit. Kjo pajisje ndeshet me kufinjtë e ekspozimit të RF gjatë përdorimit edhe në pozitë normale kundrejt veshit ose kur ndodhet në pozitë së paku 1,5 centimetra (0,6 inç) nga trupi. Kur përdoret një këllëf, kapse e rripit ose mbajtës për ta përdorur pajisjen kur është e "veshur" në trup, ai/ajo nuk duhet të përmbajë pjesë metalike dhe pajisjen duhet ta vendosin larg nga trupi juaj në distancën që u përmend më lart.

Informacion shtesë mbi sigurinë

Për të transmetuar skeda të të dhënave ose mesazhe, kjo pajisje kërkon një lidhje cilësore me rrjetin. Në disa raste, transmetimi i skedave të të dhënave ose i mesazheve mund të pezullohet derisa të disponohet një lidhje e tillë. Sigurohuni që udhëzimet e mësipërme lidhur me distancën e ndarjes të ndiqen derisa të mbarohet transmetimi.

Disa pjesë të pajisjes janë magnetike. Pajisja mund të thithë materiale metalike. Mos vendosni karta bankare ose mjete që mbajnë të dhëna në formë magnetike, sepse informacioni i ruajtur në to mund të fshihet.

Pajisjet mjekësore.

Veprimi i çdo aparature radiotransmetuese, duke përfshirë këtu dhe telefonat celularë, mund të ndërhyjnë në funksionimin e pajisjeve mjekësore të pambrojtura mirë. Konsultohuni me një mjek apo me fabrikuesin e pajisjes mjekësore për të përcaktuar nëse ato janë blinduar mirë për tu mbrojtur nga energjia e jashtme RF ose në qoftë se keni ndonjë pyetje. Mbylleni telefonin në ambientet e qendrave shëndetësore kur çfarëdolloj rregulli i vendosur në këto ambiente ju udhëzon që të veproni në këtë mënyrë. Spitalet

Informacion shtesë mbi sigurinë

ose qendrat shëndetësore mund të përdorin aparatura që mund të jenë të ndjeshme ndaj energjisë së jashtme RF.

Stimuluesit kardiakë

Fabrikuesit e stimuluesve kardiakë rekomandojnë që të mbahet të paktën një largësi minimale prej 15,3 cm (6 inç) midis një telefoni celular dhe një stimuluesi kardiak, në mënyrë që të shmanget një ndërhyrje e mundshme me stimuluesin. Këto rekomandime bazohen në një kërkim shkencor të pavarur të rekomanduar nga Kërkimet Shkencore për Teknologjinë Celulare. Personat që mbajnë stimulues kardiak duhet:

- Ta mbajnë pajisjen gjithmonë në një distancë më të madhe se 15,3 centimetra (6 inç) larg nga stimuluesi kardiak.
- Të mos e mbajnë pajisjen në xhepa afër gjoksit
- Ta mbajnë pajisjen në veshin në anën e kundërt të stimuluesit kardiak që të pakësojnë mundësinë për interferencë.

Në qoftë se dyshoni se ka interferencë, fiken pajisjen dhe largojeni atë.

Aparatet ndihmëse të dëgjimit

Disa pajisje dixhitale celulare mund të intereferojnë me disa aparate ndihmëse të dëgjimit. Në qoftë se shkaktohet intereferencë, konsultohuni me furnizuesin tuaj të shërbimit.

■ Automjetet

Sinjalet RF mund të ndikojnë në sistemet elektronike të pablinduara ose të painingaluar mirë që mund të ketë automjeti. Sisteme të tilla janë: sistemi elektronik i injeksionit të karburantit, sistemet elektronike të kundërblokimit të frenimit, sistemet elektronike të kontrollit të shpejtësisë, sistemet e jastëkëve të ajrit. Për informacion të mëtejshëm, pyesni fabrikuesin e automjetit tuaj ose përfaqësuesit e tij ose për ndonjë aparaturë që është shtuar.

Vetëm një personel i kualifikuar duhet t'i bëjë shërbim ose ta instalojë pajisjen në automjetin tuaj. Shërbimi ose instalimi i gabuar mund të jetë i rrezikshëm dhe mund të zhvlerësojë çdo garanci që ka pajisja. Kontrolloni rregullisht nëse të gjitha aparaturat e pajisjes celulare të instaluar në

Informacion shtesë mbi sigurinë

automjetin tuaj janë të vendosura dhe punojnë si duhet. Mos ruani lëngje djegëse, gaze ose materiale eksplozive në të njëjtën kabinë me pajisjen, pjesët ose pajisjet e saj ndihmëse. Për automjetet me jastëkë me ajër, duhet të kini parasysh që ato hapen me forcë të madhe. Mos vendosni objekte, duke përfshirë këtu dhe aparaturat e instaluar ose portative celulare, në zonën mbi jastëkun e ajrit apo në atë ku ai hapet. Në qoftë se një-pajisje celulare brenda në veturë është instaluar në mënyrë të gabuar dhe jastëku me ajër hapet, kjo mund të rezultojë me dëtime serioze.

Ndalohet përdorimi i pajisjes suaj gjatë fluturimit me aeroplan. Mbylleni pajisjen para se të hipni në aeroplan. Përdorimi në aeroplan i telepajisjeve celulare mund të jetë i rrezikshëm për funksionimin e aeroplanit, ndërpret rrjetin e telefonit celular si dhe mund të jetë ilegal.

■ Ambientet e mundshme shpërthyesë

Mbylleni pajisjen tuaj kur jeni në zona me atmosferë të mundshme shpërthyesë dhe zbatoni të gjitha shenjat dhe udhëzimet. Atmosferat e mundshme shpërthyesë përfshijnë zonat në të cilat ju normalisht mund të këshilloheni ta

Informacion shtesë mbi sigurinë

shuani motorin e automjetit tuaj. Shkëndijat në zona të tilla mund të shkaktojnë një shpërthim ose zjarr që çon në plagosje ose dhe në vdekje. Mbylleni pajisjen tuaj në pikat e karburantit si p.sh. afër pompave të karburantit në stacionet e shërbimit. Vëshgoni kufizimet rreth përdorimit të radioaparaturave në depot e karburantit, pikat e shpërndarjes uzinat kimike ose në vende ku janë duke u zhvilluar shpërthime. Zonat me një atmosferë të mundëshme shpërthyes janë zakonisht (por jo gjithmonë) të piketuara qartë. Ato përfshijnë hambarët e anijeve, mjetet e ruajtjes ose të transportimit të lëndëve kimike, automjetet që përdorin karburante me prejardhje nga gaze të lëngëzuara (siç janë propani apo butani), dhe zonat ku ajri përmban lëndë kimike ose pjesëza siç janë pluhuri, ose pluhurat metalikë.

■ Thirrjet e urgjencës



E rëndësishme: Telefonat celular, duke përfshirë edhe këtë pajisje, punojnë me përdorimin e radio sinjaleve, rrjeteve celulare, rrjeteve me kabëll nëntokësor dhe funksione të programuara nga përdoruesi. Për këtë arsye nuk mund të garantohet lidhja në të gjitha rrethanat. Ju nuk duhet të mbështeteni vetëm në pajisjet celulare për komunikimet thelbësore siç janë urgjencat mjekësore.

Për të bërë një thirrje urgjence:

1. Nëse pajisja nuk është e hapur, hapeni. Kontrolloni për një fuqi të përshtatshme të sinjalit.
Disa rrjete mund të kërkojnë që karta e vlefshme SIM të jetë e futur ashtu si duhet në pajisje.
2. Shtypni butonin e mbylljes aq herë sa të jetë e nevojshme për të pastruar hapësirën e shfaqjes dhe për të përgatitur pajisjen për thirrjet.

Informacion shtesë mbi sigurinë

3. Fusni numrin zyrtar të urgjencës për lokalitetin ku ndodheni aktualisht. Numrat e urgjencës ndryshojnë sipas lokalitetit.
4. Shtypni butonin e telefonatës.

Në qoftë se disa mundësi janë duke u përdorur, juve do t'ju duhet që t'i mbyllni ato përpara se të bëni një thirrje të urgjencës. Për informacion të mëtejshëm, konsultohuni me këtë udhëzues ose me furnizuesin tuaj të shërbimit.

Kur jeni duke kryer një thirrje të urgjencës, jepni të gjithë informacionin e nevojshëm sa më saktë që të jetë e mundur. Pajisja juaj celulare mund të jetë ndoshta mjeti i vetëm i komunikimit në vendin e aksidentit. Mos e përfundoni thirrjen derisa t'ju japin lejen për ta përfunduar.

Informacioni për vërtetimin (SAR)

KJO PAJISJE CELULARE I PËRMBUSH ORIENTIMET
NDËRKOMBËTARE PËR EKSPOZIMIN NDAJ VALËVE TË
RADIOS.

Pajisja juaj celulare është një radiotransmetuese dhe radiomarrëse. Ajo është projektuar në mënyrë të tillë që të

Informacion shtesë mbi sigurinë

mos i kalojë kufijtë e ekspozimit ndaj valëve të radios të rekomanduara nga orientimet ndërkombëtare. Këto orientime u zhvilluan nga organizata shkencore e pavarur ICNIRP dhe përfshijnë kufijtë e lejuar të sigurisë të projektuar për të siguruar mbrojtjen e të gjithë personave, pa përjashtim të moshës apo gjendjes shëndetësore.

Direktivat e ekspozimit për pajisjet celulare përdorin një njësi matëse të njohur si Koeficienti Specifik i Absorbimit, ose SAR. Kufiri i SAR-it i deklaruar në orientimet e ICNIRP është 2.0 vat/kilogram (W/kg) për mesatarisht 10 gram ind. Testet për SAR-in janë kryer duke përdorur pozicione standarde të përdorimit, me pajisjen që transmeton në nivelin më të lartë (të vërtetuar) të fuqisë së saj në të gjitha bandat e testuara të frekuencave. Niveli aktual i SAR-it të një pajisjeje në funksionim, mund të jetë më poshtë sesa vlera maksimale sepse pajisja është projektuar për të shfrytëzuar vetëm fuqinë e kërkuar për të kapur rrjetin. Kjo sasi ndryshon në varësi të një numri faktorësh si p.sh. nga distanca midis jush dhe stacionit bazë të rrjetit. Vlera më e lartë e SAR-it sipas orientimeve të ICNIRP për përdorimin e pajisjes në vesh është 0,78 W/kg.

I n f o r m a c i o n s h t e s ë m b i s i g u r i n ë

Përdorimi i pajisjeve ndihmëse dhe aksesoreve të pajisjes mund të rezultojë në vlera të ndryshme të SAR-it. Vlerat e SAR-it mund të ndryshojnë në varësi të kërkesave kombëtare të raportimit dhe testimit, si dhe bandës së rrjetit. Informacion shtesë për SAR-in mund të ofrohet nën informacion mbi produktin në www.nokia.com.